



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/166

Datë: 14.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2014, mori:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi me krijimin e të drejtës së servitutit sendor për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i trasesë për vendosjen e tubacioneve të ngrohjes nga Ndërmarrja Publike Ngrohtorja e Qytetit "Termokos Sh. A. "Prishtinë, deri në TC Kosova B, Obiliq, Zonat Kadastrale Prishtinë, Shkabaj dhe Obiliq, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të

drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, përfituesi i Shpronësimit Kompania Publike "Termokos" Sh. A. do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/166  
Datë: 14.01.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Segmentit Rrugor 7.3 që lidhë Autostradën Vërmicë-Merdare R7, Autoudhen R6 Prishtinë-Hani i Elezit dhe Rrugën Magjistrale M2, Zona Kadastrale Çagllavicë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelës të bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas Udhëzimit Administrativ për vlerësim të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit/MMPH, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë